



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

PROGRAMET PARANDALUESE

KUJDESI SHËNDETËSOR PARËSOR

PROGRAMI 300 QENDRAVE SHËNDETËSORE

INVESTIMET NË SHËNDETËSI

NJËSI E RE E HEMODINAMIKËS

SHËRBIMI AFËR VENDBANIMIT

DISIPLINA NË SPITALE

DREJTUESIT E RINJ TË SHËRBIMEVE NË QSUT

DIPLOMOHEN STUDENTËT E MJEKËSISË

DITARI JAVOR

18-24 Shkurt 2019

Në qendrën shëndetësore Babrru, në zonën e Paskuqanit, e rehabilituar plotësisht me buxhetin e shtetit, ka nisur edhe programi i depistimit të kancerit të qafës së mitrës për gratë e grupmoshës 40-49 vjeç. Ky program parandalimi po shtrihet në të gjithë Tiranën dhe benda muajit Mars, në të gjithë vendin.

103 mjekë të përgjithshëm konkuruan për t'u bërë pjesë e ekipit të shëndetësisë në kujdesin parësor. 54 prej tyre u punësuan në qendrat shëndetësore dhe ambulancat nga veriu në jug të vendit, ndërsa është në proces punësimi i mjekëve në shërbimin shëndetësor parësor në Tiranë.

Mbi 4700 banorët e Lunxhërisë, e marrin shërbimin parësor në kushte dhe standarde bashkëkohore, falë rehabilitimit të qendrës shëndetësore Lunxhëri. Kjo qendër është një prej 8 qendrave të rehabilituara në qarkun e Gjirokastrës, pjesë e programit të 300 qendrave moderne shëndetësore.

Pas më shumë se dy dekadash, rehabilitohet Dispanceria e Tiranës. Klinika e specializuar për sëmundjet e mushkërive, ofron sot një standard të ri shërbimi për banorët e kryeqytetit, falë investimit prej 56 milionë lekë nga buxheti i shtetit në infrastrukturë dhe pajisje mjekësore moderne.

Realizohet procedura e parë e angiografisë koronare në spitalin rajonal të Fierit. Pas Tiranës dhe Shkodrës, zgjerohet harta e Njësive të Hemodinamikës, për herë të parë edhe në jug të vendit, në shërbim të pacientëve me probleme kardiake.

13 mjekë specialistë i shtohen spitalit rajonal të Gjirokastrës, duke mundësuar ofrimin e shërbimit të specializuar afër vendbanimit të qytetarëve. Brenda muajit Shkurt, pritet të përfundojnë specializimin 300 mjekë specialistë, pas një bllokimi 4-vjeçar të specializimeve në mjekësi.

Vendoset regjimi i ri në spitale, me disiplinimin e orarit të vizitave të familjarëve në çdo spital universitar, rajonal dhe bashkiak në vend. Oraret e vizitave janë unifikuar në të gjitha pavionet dhe repartet e reanimacionit, ndërsa në urgjenca nuk do të lejohen familjarë, përveç rasteve kur kërkohet nga mjeku.

Prezantohen 33 drejtuesit e rinj të shërbimeve në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza". Procesi i përzgjedhjes, solli emra të rinj, por edhe rikonfirmoi personalitete të fushës së mjekësisë në drejtimin e shërbimeve universitare.

Mbi 2 mijë studentë të fakulteteve të Mjekësisë dhe Infermierisë u diplomuan dhe janë gati t'i bashkohen sistemit shëndetësor në vend. Me Paktin për Universitetin, çdo student ekselent, do të hyjë në procedurat e konkurimit për t'u punësuar, me 10 pikë bonus.